

Sipas dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut me Nr. 2001/35, mbi Pensionet në Kosovë, të datës 22 Dhjetor 2001,

Me qëllim të ekzekutimit të Nenit 15.7 dhe 22.7 të Rregullores së UNMIK-ut me Nr. 2001/35, raportet vjetore dhe raportet tjera financiare dhe informatat mbi pensionet që Fondi i Pensionit ose Siguruesi i Pensionit kërkohet që ti parashtroj në BPK,

Bordi Drejtues i Autoritetit Bankar të Pagesave të Kosovës(BPK), në mbledhjen e mbajtur me 23 tetor 2002 miraton si vijon:

Rregulla 23 mbi raportet dhe informatat tjera të kërkuara nga Fondi i Pensionit dhe Siguruesi i Pensionit që të parashtrohen

Neni 1

Sfera dhe qëllimi i Rregullës

1.1 Sfera e Rregullës

Kjo rregull i adresohet të gjitha Fondeve të Pensionit dhe Siguruesve të Pensionit.

Në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 15.7 dhe 22.7 të Rregullores së UNMIK-ut me Nr. 2001/35 (“Rregullorja e Pensionit”), BPK-ja mundë të kërkojë informata dhe raporte të tjera nëse konsiderohen si të nevojshme për rolin e saj mbikqyrës në mënyrë që të mbrojtë interesin e pjesëmarrësve të pensioneve.

1.2 Qëllimi i Rregullës

Kjo Rregull përshkruan raportet e kërkuara të Fondit të Pensionit dhe Siguruesit të Pensionit në BPK të cilat janë dizajnuar që të sigurojnë BPK-n me të dhëna dhe informata adekuate dhe të sakta për kushtet financiare të këtij Entiteti të Pensionit dhe mënyrën me të cilën ata administrojnë dhe menagjojnë programet e tyre të pensioneve, të sigurohet se me kërkesat e Rregullores së Pensioneve dhe përcaktimeve në Urdhëresat e tyre të Pensionit dhe/ose Rregullat e Pensionit janë zhvilluar për mbrojtjen e pjesëmarrësve të pensioneve dhe përfituesve të pensioneve.

Neni 2

Dispozitat e përgjithsme

2.1 Definimi

Të gjitha termet e shfrytzuara në këtë Rregull janë ashtu siq janë definuar dhe përcaktuar në Rregulloren e Pensionit dhe/ose siq definojnë më pas në këtë Rregull.

“Actuary” (ekspert) nënkupton individin i cili, duke u bazuar në shkollimin e asaj/atij, trajnimin dhe përvojën, ka pranuar që të posedojë shkathhtësitë në kryerjen e llogaritjeve matematikore në lidhje me vlersimin dhe financimin e programit të Pensionit me Benefit të Definuar, që punon për vete ose për firm, dhe i cili është i njohur nga BPK-ja si ekspert i kualifikuar i pensioneve.

“Raporti aktual” ose “Raporti i vlersimit actuarial” nënkupton raportin që tregon mjetet dhe detyrimet, dhe kërkesat e financimit (kontributet), për Pensionin me Benefit të Definuar duke përfshirë metodat, supozimet dhe të dhënat e shfrytzuara për të arritur të konkluzionet aktuariale, të pregaditura sipas udhëzimeve dhe nënshkrimit të Ekspertit.

“Raportet financiare vjetore të revizuara” përfshijnë Raportin e Mjeteve dhe Detyrimeve në fund të çdo viti që përfundon në të njëjtin vit financiar, duke u përfshirë kur kërkohen me Rregullën 15 të këtyre Rregullave Raporti actuarial, dhe raporte tjera të tilla, planet dhe shënimet, të pregaditura në mënyrën që është në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

“Viti financiar” nënkupton periodën prej 12 muajve të njëpasnjëshëm që fillojnë me fillimin e çdo muaji të Janarit dhe përfundojnë me 31 Dhjetor të çdo viti; viti i parë i viteve të tilla financiare përfundon me 31,2002.

“Entiteti i Pensionit” i referohet Fondit të Pensionit që ofron Pensionin Suplementar Pundhënës dhe/ose Siguruesi i Pensionit që ofron Pensionin Suplementar Individual.

“Tremujor” nënkupton periodën e çdo 3 muajve të njëpasnjëshëm që fillojnë në ditën e parë të çdo viti financiar. Perioda tremujore përfundon me çdo 31 Mars, 30 Qershor dhe 30 Shtator të çdo viti.

Neni 3 Raporti financiar

3.1 Kërkesat e Raportëve Financiare të revizuara

- a) Revizioni vjetor. Entitetet e Pensionit duhet të parashtrajnë për një revision vjetor të jashtëm nga kontabilisti i qertifikuar ose i pavarur, në raportin e tij vjetor financiar.
- b) Standardet e revizionit. Revizioni do të zhvillohet dhe raporti i revizionit duhet të pregaditet dhe qertifikohet në konformitet me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit ose standardeve të kontabilitetit të Kosovës.

- c) Koha e fajlimit të raportit financiar vjetor të revizionuar. Entitetet e Pensionit duhet të parashtrijnë në BPK tri (3) kopje të raportit vjetor financiar të revizionuar për të mbuluar vitin financiar që përfundon, para ose në periodën prej katër (4) muajve prej ditës së fundit të vitit të tillë financiar.
- d) Përgjegjësia për raportet financiare të revizionuara. Trupi drejtues i entitetit të pensionit është përgjegjës për informata financiare që gjenden në raportet e tyre financiare vjetore të revizionuara. Vendimi i trupit drejtues që përshtat dhe miraton raportet e revizionuara financiare duhet të fajlohet në BPK së bashku me raportet vjetore financiare të revizionuara.
- e) Zhvillimi i revizionit dhe kërkesat për të qenë transparente, detyrat dhe obligimet e revizorit të jashtëm dhe entiteti i pensionit janë parashkruar sipas Rregullës 24 të këtyre Rregullave.

3.2 Raportet dhe informatat e kërkuara që të parashtrihen në BPK

Entitetet e Pensionit duhet të parashtrijnë raportet dhe informatat si vijojnë në BPK:

- a) Raportet tremujore. Për derisa tjera raporte nuk kërkohen nga BPK-ja në pajtueshmëri me Rregulloren e Pensionit, entitetet e pensionit duhet të parashtrijnë në BPK raportet dhe informatat si vijojnë, në mënyrë elektronike ose në formë të letrës, brenda 20 ditësh kalendarike pas ditës së fundit të tremujorit për të cilin është bërë raporti:
 - 1. Lista e Mjeteve të Pensionit në konformitet esencial me kërkesat e paraqitura në Listën Q1 (Forma e Pensionit të BPK-s 010), të këtyre Rregullave.
 - 2. Raporti i Shitjes dhe Përvetsimit të Mjeteve të Pensionit në konformitet me kërkesat e paraqitura në Listën Q2 (Forma e Pensionit të BPK 011) e këtyre Rregullave.
- b) Raportet vjetore. Për derisa raportet tjera janë kërkuar nga BPK në pajtueshmëri me dispozitat e Rregullores së Pensionit, entitetet e pensionit duhet të parashtrijnë në BPK raportet si vijon që mbulojnë vitin financiar që sapo ka përfunduar, me transmetim në formë të letrës ose në mënyrë elektronike, brenda 60 ditësh kalendarike pas fundit të vitit të ri financiar për të cilin është bërë raporti.
 - 1. Fleta e Bilancit (Raporti i Mjeteve dhe Detyrimeve) në fundë të vitit financiar e nënshkruar nga Kryetari dhe Sekretari i bordit të drejtorëve, në rastë të Fondit të Pensionit, dhe në rastë të Siguruesit të Pensionit, Kryetarit të tij dhe Shefit Kryesor të Financave.

Mjetet e Pensionit janë zhvilluar në Fletën e Bilancit në vlerën e tyre të përcaktuar në pajtim me Rregullën 6 të këtyre Rregullave.

Në rastë të rregullimit pensional me Kontribut të Definuar, detyrimet e entitetit të Pensionit duhet që përveq detyrimeve tjera, të përfshihet shuma totale e mjeteve të shpërndara në llogaritë individuale të pjesmarrësve të raportuara në vlerat e tashme në fundë të vitit financiar.

Në rastë të skemës së Pensionit me Benefit të Definuar, detyrimet e entitetit të Pensionit duhet që në mes tjerave detyrime, të përfshijnë dispozitat teknike të kërkuara të llogaritura në pajtim me Rregullën 15 të këtyre Rregullave, duke prezentuar detalet e Detyrimeve Aktuariale dhe Detyrimet e Pagimit, sikur që këto terme janë definuar në Rregullën 15.

2. Lista e Mjeteve të Pensionit me datën e vlersimit prej ditës së fundit të vitit financiar, në konformitet të plotë me kërkesat e paraqitura në Listën A1 (Forma e Pensionit të BPK 008), të kësaj Rregulle.
 3. Raporti i taksave të paraqitura gjatë vitit financiar në konformitet esencial me kërkesat e paraqitura në Listën A2 (Forma e Pensionit të BPK-s 009), të kësaj Rregulle.
 4. Raporti që justifikon taksat e ngarkuara aktualisht për qdo Llogari Individuale gjatë viti financiar dhe paraqitjen e mëhershme të listës së propozuar të taksave për vitin e ardhshëm financiar, në rast të skemës së Pensionit me Kontribut të Definuar.
- c) Raporti i Vlersimit Aktuarial i pregaditur në formë dhe kohë i parashkruar sipas Rregullës 15 të këtyre Rregullave, brenda 60 ditësh të datës së vërtetimit të Ekspertit, në rastë të skemës së Pensionit me Kontribut të Definuar.

Neni 4 Informatat tjera që kërkohen

4.1 Kërkesat për informata që do të shoqërojnë raportet

- a) Për Pensionet me Kontribut të Definuar, këto si vijojnë duhet të përfshihen në raportin vjetor ose të paraqitura në shënime për raportin vjetor:
 1. Shuma e kontributeve në fundë të vitit financiar që nuk është pranuar nga entiteti i pensionit.
 2. Qdo pjesë e mjeteve të pensionit për qka është caktuar vlera që nuk është në pajtim me Rregullën 6 të këtyre Rregullave dhe justifikimi për shfrytëzimin e bazave të vlersimit.

3. Niveli i të ardhurave nga investimet aktuale të bëra në krahasim me shkallën e projektuar të të ardhurave; me një sqarim të ndryshshmërisë, nëse ndryshimi i tillë ose ndryshimet janë plus ose minus 50% të shkallës së projektuar në relacion me llojin specifik ose llojet e investimeve, ose nëse ndryshimi total është më i lartë se plus ose minus 30% të projeksioneve, dhe diskutimi i shkallës së projektuar të të dhënave për vitin financiar që vijon.
 4. BPK-ja mundë të kërkojë ndonjë qështje të transparencës, kohë pas kohe.
- b) Për Pensionin me Benefit të Definuar, informata si vijojnë duhet të përfshihen ose tregohen në raportin vjetor ose të ofrohen në shënim të bashkangjitur për raportin vjetor:
1. Kualiteti i financimit, sikur që është definuar në Rregullën 15, të këtyre Rregullave, të rregullimit pensional.
 2. Data e Vlersimit të fundit Aktuarial të skemës së pensionit dhe një vlersim i shkallës së saktësisë të këtij vlersimi actuarial në relacion me obligimet e tanishme të skemës së Pensionit.
 3. Kërkesat e likuiditetit të fondit të pensionit për vitet e ardhshme (së paku 3 vite) duke përfshirë vitin e tanishëm dhe një sqarim se si këto kërkesa të likuiditetit duhet të plotsohen.
 4. Deficiti i njohur ose i paraqitur në fond dhe lista e financimit të këtyre deficiteve. Fondi i pensionit duhet të paraqet ndaras vlerën që prezenton Deficitin para-planit dhe Deficitin e Shërbimit të Hershëm, sikur që termet janë definuar në Rregullën 15 të këtyre Rregullave, dhe niveli i besnikrisë në listën e parashkruar të financimit.

4.2 Deklarata e Principeve të Investimit dhe Udhzimet

Entiteti i Pensionit duhet të parashtrij në BPK një kopje të Deklaratës më të re të Principeve të Investimit dhe Direktivave Brenda 30 ditësh të ndonjë ndryshimi ose amandamenti. Poashtu duhet ta furnizojë BPK-n me një kopje të Direktivave të Investimeve të lëshuara, nëse ka, për Menagjerin(et) e Mjeteve Brenda 15 ditësh të datës së lëshimit ose të ndonjë ndryshimi.

4.3 Informatat që ndihmojnë mbikqyrjen

BPK-ja mundë të kërkojë informata tjera nga Entiteti i pensionit, drejtorët e tij, dhe/ose oficerët, që janë vërtetë të nevojshme për të ndihmuar funksionin mbikqyrës të

aktiviteteve të biznesit të siguruesve të shërbimit të Enitetit të Pensionit ose të ndonjë eniteti që janë ose mundë të jenë nën rolin mbikqyrës dhe rregullator të BPK-s

Neni 5
Hyrja në fuqi

Kjo Rregull do të hyj në fuqi më 23 tetor 2002.

Drejtori i Përgjithshëm